



Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Nëna Terezë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381 38 224 783; Fax: +381 38 244 035

Email: filozofiku@uni-pr.edu, www.uni-pr.edu

Fakulteti Filozofik

Departamenti i Historisë

Rezyme e punimit: “Memorandumi i ASSHA 1986 si pikënisje e shpërbërjes së Jugosllavisë dhe pushtimit serb të Kosovës”

“Memorandumi i ASSHA 1986 si pikënisje e shpërbërjes së Jugosllavisë dhe pushtimit serb të Kosovës” si temë për plotësimin e pjeshëm të obligimeve për të fituar titullin Master i Historisë- Koha e Re.

Kosova, si territor kishte mbetur që nga vitit 1912 në Mbretërinë Serbo-Kroate-Slllovene dhe kështu vazhdoi deri në fillimin e Luftës së Dytë Botërore (1939-1945) e më pastaj përsëri pas përfundimit të saj. Mirëpo që kësaj radhe përfundimi i Kosovës brenda Serbisë rrjedhimisht brenda Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë, nuk ndodhi paqësisht por me intriga nga pala serbo-jugosllave dhe me kundërshtime nga ana shqiptare. Intrigat serbo-jugosllave ishte që në një formë a tjetrën të minohej e drejta e vetëvendosjes e popullit shqiptar duke i zëvendësuar Këshillat Nacionalçlirimtare të përbëra nga shqiptarët me Këshilla të mbizotëruar nga ana e serbo-malazezve, të cilët do të paraqisnin në mënyrë të rrejshme se dëshira dhe synimi i popullit të Kosovës ishte që ai të i bashkohej Serbisë. E që kjo do të arrihej në korrikun e vitit 1945, kur Kuvendi i Prizrenit votoi dhe kërkoi aneksimin e Kosovës nga ana e Serbisë.

Ndërsa rezistenca e shqiptarëve ndaj aneksimit serb të Kosovës, ndodhi përgjatë fundit të vitit 1944 dhe fillimit të vitit 1945, dhe më e njohura është ajo e trevës së Drenicës e udhëhequr nga ana e Shaban Polluzhës.

Pas aprovimit të "kërkesës" të Kuvendit të Prizrenit dhe aneksimit të Kosovës nga ana e shtetit federativ të Jugosllavisë, me kushtetutën e vitit 1946, Kosova, u përcaktua si Rajon autonom i Serbisë nën emërtimin Kosovo e Metohi apo KosMet. Kjo ishte ndër pabarazitë e para që iu bënë shqiptarëve brenda RPFJ, pasi që për dallim nga Kosova, Vojvodina ishte njohur si krahinë autonome e Serbisë.

Pabarazitë vazhduan edhe përgjatë viteve tjera, dhe për një periudhë të gjatë 20 vjeçare shqiptarët në atë që njihet si periudha e Rankoviçit. Kjo periudhë ishte mjaft e palakmueshme për shqiptarët, ata iu nënshtruan një repreziale të pushtetit të udhëhequr nga ana e Aleksandër Rankoviçit. Vitet më të vështira për shqiptarët përgjatë kësaj periudhe ishin 1953-1956, të cilat patë ndikim të madh në rëndimin e gjendjes sociale, politike, ekonomike të shqiptarëve. Kështu gjatë kësaj kohe nisi fushata për shkombëtarizimin e shqiptarëve, aksioni i mbledhjes së armëve dhe shpërngulja e shqiptarëve drejt Turqisë. Të gjitha këto çonin drejt qëllimit shumëvjeçar që ishte shpopullimi i Kosovës nga shqiptarët dhe zëvendësimi i tyre me serbë, gjë kjo që ishte hartuar dhe parashikuara edhe nga ana e Ilija Grashaninit, ideatorit të Serbisë së Madhe, dhe programit të tij politik të vitit 1844 Naçertanijes.

Të gjitha këto përjetime negative që i kishin patur shqiptarët gjatë kësaj kohe, shtoi këtu gjendjen ekonomike, mohimi i arsimit në gjuhën amtare sidomos arsimit të lartë, rënies së Rankoviçit dhe për shumë arsye të tjera shqiptarët do të arrinin që në vitin 1968, në muajve tetor dhe nëntor, do të shpërthenin demonstrata në qytet si në Prizren, Pejë, Podujevë, Ferizaj, Gjilan dhe në Prishtinë. Demonstrata e Prishtinës do të ishte një ndër më të mëdhatë dhe ato që do të ia arrinin qëllimit që të zgjonin sado pak edhe kureshtjen dhe vëmendjen e ndërkombëtarëve për Kosovën dhe popullin e saj. Kështu që nga përfundimi i këtyre demonstratave, filluan gradualisht të fitohen disa të drejta nga ana e shqiptarëve, ndër të parat ishte hapja e Universitetit të Prishtinës e për të kulmuar më 1974, kur Kosova falë ndryshimeve kushtetuese do të kalonte nga një Rajon autonome më një status si aktin më të lartë juridik në një Krahinë autonome që kishte kushtetutën e saj e cila në një masë i jepte një barazi me njësit e tjera federative të Jugosllavisë.

Këto të drejta që u fituan që nga vitit 1968 e tutje, filluan të zbehen/humbin që nga viti 1981, vit pikërisht në të cilin do të ndodhnin edhe demonstratat fillimisht të studentëve më 11 mars e pastaj edhe gjithëpopullore gjatë 25 e 26 marsit dhe 1 e 2 prillit 1981. Këto demonstrata qoftë nga vetë studentët por dhe nga ana e studiuesve shihen se fillimisht kishin kërkesa sociale për të kaluar pastaj në ekonomike, propolitike dhe politike. Nëse demonstratat e vitit 1968 sollën

disa të drejta ekskluzive për shqiptarët e Kosovës (por që patën efekte edhe për shqiptarët që jetonin në tjera njësi të Jugosllavisë), demonstratat e vitit 1981 ndikuan që gradualisht të minimizohen ato të drejta që i kishin fituar që nga viti 1968-1969 e deri më 1974.

Në vazhden e minimizimeve të të drejtave të shqiptarëve, ndodhi edhe Memorandumi i ASSHA i vitit 1986, i cili në njëfarë forme synim kryesor kishte legjitimimin e dhunës serbe karshi popujve të shtypur, kjo pra do të legjitimohej në mënyrë që veprimet serbe edhe të shiheshin si normale, mirëpo në mënyrë indirekte Serbia të arrinte t'i realizonte qëllimet e saj që kishte në territoret e Kosovës dhe jo vetëm.

Memorandumi, më vonë do të i shërbente mjaftueshëm politikës së Slllobodan Millosheviçit, i cili në fund të viteve 80-ta do të vinte në krye të Serbisë e më pastaj të Jugosllavisë. Ardhja e tij bëri që të fillonin veprimet për realizimin e qëllimeve të Akademisë dhe politikës serbe, kështu ndër veprimet e para do të ishte ndryshimet kushtetuese të cilat do të i jepnin Serbisë më shumë të drejta mbi krahinat e saja. Duke i nuhatur këto gjëra të cilat do të ndodhnin, filluan menjëherë reagime nga ana e shqiptarëve të Kosovës, u pakësua numri i të anëtarësuarve në Lidhjen Komuniste të Kosovës, por edhe një lëvizje mjaftë e madhe, greva e minatorëve të Trepçës.

Kjo grevë do të zgjaste 8 ditë në zgafellën e minierës së Trepçës, dhe minatorët kishin kërkesat e tyre për të ndaluar grevën. Ndër kërkesat e tyre kryesore ishte të ndaloheshin veprimet që do të cenonin kushtetutshmërinë e vitit 1974 dhe kërkonin dorëheqjen e udhëheqësish kosovare në mesin e të cilëve ishte Rrahman Morina.

Greva e minatorëve do të përfundonte më 28 shkurt, por që pothuajse afër një muaj më vonë veq se do të ndodhte suprimimi i autonomisë së Kosovës (23 mars 1989), që do të ishte edhe fillimi i fundit të robërisë së Kosovës nën Jugosllavinë. Kështu do të fillonin edhe shumë e shumë lëvizje.

Në korrik të 1990, më 2 korrik, do të ndodhte shpallja e Kosovës si njësi e barabartë me njësitë e tjera federale duke u shpallur Republikë. Mirëpo kjo u pa që nuk ishte e mjaftueshme dhe më pas më 26-30 shtator 1991 u organizua një referendum popullor në të cilin shqiptarët e Kosovës vendosen për pavarësimin e Kosovës nga RSF e Jugosllavisë. Pas që ishte shpallur Kosova, shtet i pavarur atëherë ndihej nevoja e formimit të institucioneve shtetërore, kështu u organizuan zgjedhjet e para parlamentare dhe presidenciale më 24 maj 1992, në të cilat fituese doli LDK- Lidhja Demokratike e Kosovës, e cila ishte formuar në fund të vitit 1989. Kështu me

përfundimin e zgjedhjeve dhe krijimi e institucioneve të presidentit dhe të ekzekutivit, u pa që ishte e nevojshme krijimi i një sistemi të pavarur të arsimit dhe shëndetësisë.

Nga ky sistem që u krijua i arsimit, më vonë më 1997 do të ndodhnin edhe demonstratat e tetorit të organizuara nga ana e studentëve shqiptarë të Universiteti të Prishtinës dhe që kishin përkrahjen e rektoratit. Poashtu viti 1997 do të ishte mjaft i frytdhënës, pasi që do të ndodhte edhe paraqitja e parë publike e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Bsc. Dashmir Susuri